POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Tiranë/ Vdesin nga asfiksia! Pronari dhe i afërmi harruan ndezur ngrohësen me gaz te Koda e PrPd', policia i gjen pa jetë në banesë (VIDEO+EMRAT)
2 Ndarja nga bashkëshorti pas 15 vitesh martese! Dalina Buzi: Isha si tërmet 7 balle
3 Berisha: Ndërprisni seancën, votoni gjenocidin serb në Kosovë! Spiropali: Nesër dy Kuvendet do dalin me një deklaratë të përbashkët
4 Kuvend/ Mbrojtja e të dhënave personale përpjan mazhorancën me opozitën, Manja: Sankzione deri në 10 mln euro, Tabaku: I vendosni dhe më pas i falni
5 Noka shtyu Shehajn në Kuvend/ Haklaj: Sherri, me urdhër të Ballukut! Islami: Këta zihen si qentë për kocka! Mërtiri: Ndodhi për koncesionarin, mik me Berishën

Kronikë

AMP arreston 2 policë! Njëri u denoncua nga ish-bashkëshortja, theu urdhrin e mbrojtjes dhe i vodhi valixhen me 5 milion lekë

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka arrestuar në flagrancë dy punonjës policie, përkatësisht Inspektorin Llesh Tusha që ushtronte detyrën në Komisariatin e Mirditës dhe Inspektorin Jaçe Reçka me shërbim në Policinë e Gjirokastrës.

Redaksia
19 Dhjetor, 10:58 | **Përditesimi: 19 Dhjetor, 11:02**

Share

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka arrestuar në flagrancë dy punonjës policie, përkatësisht Inspektorin Llesh Tusha që ushtronte detyrën në Komisariatin e Mirditës dhe Inspektorin Jaçe Reçka me shërbim në Policinë e Gjirokastrës.

Polici Tusha u arrestua për veprën penale "Drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt", pasi gjatë drejtimit të një mjeti në "Rugën e Kombit", ai është përplasur me një automjet tjetër, duke shkaktuar dëme materiale. Ndërkohë, pas testit së alkoolit, ai ka rezultuar pozitiv.

Nga ana tjetër, polici Reçka u arrestua për veprat penale "Vjedhja", "Dhuna në familje", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta".

LEXO EDHE:
Më pak gjela deti në Zadrimë të Lezhës, fermerët: Ka kosto për t'i rritur dhe në fund nuk arrijmë t'i shesim

Denoncimi ka ardhur nga ish-bashkëshortja e tij, e cila ka raportuar se ai ka shkelur urdhrin e mbrojtjes dhe i ka marrë një valixhe me një shumë prej 5 milionë lekësh. Pas hetimeve, është kryer një kontroll në banesën e kunatit të punonjësit të policisë, ku janë gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 8,000 Euro, një dorezë metalike, një krehër me 7 fishekë dhe 287 fishekë pistolete.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Lezhe Gjirokaster Llesh Tusha Jace Recka

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

19 Dhjetor, 08:16

5 vite nga krijimi i SPAK, jeni të kënaqur me punën e bërë?

Po Jo Duhet më shumë

Lajme të tjera

Aksident i rëndë në rrugën Lezhë-Laç, vdes pas përplasjes së dy mjeteve shoferi 65-vjeçar! Policia procedon drejtuesin tjetër (EMRI+VIDEO)
18 Dhjetor, 10:44

Aksident në Lezhë, plagoset rëndë drejtuesi i motoçikletës! E përplasi 73-vjeçari me zetor (VIDEO)
17 Dhjetor, 15:45

Lezhë/ Hashash e thika në shkolla, shumë zhurmë pak denoncime! Drejtori i shkollës: Prindërit thonë 'pse na shqetëson!'
17 Dhjetor, 14:57

Rruga nacionale Rrëshen-Burrel e pakalueshme nga gropat dhe rrëshqitjet e tokës, nuk mirëmbahet nga ARRSH-ja! Kryebashkiaku: Kërkojmë investim nga Qeveria
Elvis Hila
17 Dhjetor, 14:41

Murtaja Afrikane e Derrave në Shëngjin, del nga karantina pas 21 ditësh zona e Malit të Rrencit! Ministria: Nga 25 nëntori s'ka asnjë rast të ri
16 Dhjetor, 15:31

'Aperitivo italiano', jazz & soul në Gjirokastër! Koncert me këngët më të bukura të muzikës italiane
Piro Nase
16 Dhjetor, 14:52

'Asnjë hap pas!' Meloni-Opozitës: Gjadri do funksionojë, edhe nëse fle atje çdo natë! Marrëvesh e emigrantëve, 'tmerri' i trafikantëve (VIDEO)
15 Dhjetor, 17:18

Krijohet Betlehemi në Lezhë, simboli i Krishtlindjeve vjen për herë të parë në këndin e festave
Elvis Hila
15 Dhjetor, 08:56

Media spanjolle 'ABC': Shqipëria fiton popularitet në mesin e turistëve ndërkombëtarë
15 Dhjetor, 08:14

Pësoi arrest kardiak, humb jetën në spital i dënuari për dhunë në familje (EMRI)
13 Dhjetor, 22:11

Berisha me grupet e punës në Lezhë për zgjedhjet 2025: Çmime janë trefishuar dhe kanë tejkaluar Gjermaninë e Italinë, shpopullimi i vendit në 40%
11 Dhjetor, 16:05

Artistët e folkut mblidhen në Lezhë për Festivalin Folklorik Tipologjik të Rapsodeve dhe Instrumentisteve, marrim pjesë në garë 18 grupe
Elvis Hila
11 Dhjetor, 15:52

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje